



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

Study program **Shkenca Politike (2016/2017)**

Fakulteti	Shkencat Shoqërore Bashkëkohore
Cikli i studimeve	Cikli i dytë (Pasdiplomike)
SETK	120
Titulli	Magjistër i Shkencave Politike
Numri në arkiv i akreditimit [120]	16-1325/1
Vendimi për fillim me punë	
Data akreditimit	20.05.2016

Përshkrimi i programit

Programi i ciklit të dytë shkencë politike është dizajnuar në atë mënyrë që studentët të fitojnë njohuri menaxhuese, këshilluese, politike, analitike, njohuri juridike, shkathtësi dhe kompetenca, të cilat do të gjejnë zbatim në organizatat qeveritare dhe joqeveritare.

Karriera

- Në fushën e shkencave politike, në politikën publike, menaxhimin e burimeve njerëzore, në ekonomi dhe institucione publike etj.
- Trajnim dhe kompetencë menaxhimi dhe shfrytëzim maksimal i burimeve për marrjen e njohurive të reja.
- Planifikimi i politikave të reja nga fusha të ndryshme që janë të rëndësishme për shtetin dhe shoqërinë.
- Përgatitje për angazhim aktiv në projekte udhëheqëse hulumtuese.
- Me njohuritë e fituara shkencore ata janë të gatshëm për t'u punësuar në institucione të specializuara nga fusha të ndryshme sektorin publik dhe qeveritarë, sektorit privat dhe shoqërisë civile.

Rezultatet e të mësuarit

Njohuritë dhe të kuptuarit

- Ka njohuri të avancuara për çështje teorike të cilat i referohen jetës politike.
- Ka edhe koncepte të thella për parimet më të rëndësishme ndaj proceseve politike.
- Njeh shumë mirë shkencat politike, përmes zhvillimit dhe zbatimit të ideve origjinale nga konteksti hulumtues.

Aplikimi i njohurive dhe të kuptuarit

- Mund të asistojë në zgjidhjen e problemeve nga natyra politike përmes planit institucional.
- Është në gjendje ta analizojë, të vlerësojë dhe të gjykojë sistemin ekzistues në Maqedoni dhe të gjejë zgjidhje të problemeve të cilat u referohen marrëdhënieve ndërkombëtare.
- Mund të marrë pjesë aktive në argumentimin e gjërave kryesore me kontekst politik dhe të aplikojë praktikat shkencore politike në situata të reja.

- Mund të përdorë të dhëna të caktuara dhe në njëherësh të diskutojë për rëndësinë e tyre në jetën politike.

Aftësitë për të vlerësuar

- Aftësi të japë mendim kritik për çështjet aktuale politike dhe të propozojë alternativa për zgjidhjen e këtyre problemeve.
- Aftësi për të zgjedhur temë dhe ta zhvillojë atë për qëllime të caktuara dhe për një auditor të caktuar me qëllim të respektimit të perspektivave të sistemeve të reja politike.
- T'i vlerësojë përparësitë dhe mangësitë e proceseve politike në Maqedoni.
- T'i argumentojë dhe t'i mbrojë dukuritë politike dhe të jetë i aftë që ato t'i mbrojë me metoda empirike dhe teorike.
- Ta vlerësojë dukurinë e institucioneve politike, punën e tyre, si komunikojnë ato me mjedisin e tyre të jashtëm, si ndikojnë në komunikimin e mjedisit të tyre të brendshëm dhe të jashtëm dhe çfarë është ndikimi i kësaj sjelljeje në mjediset kolektive dhe ato individuale.
- Të bëjë vlerësim në mes analizës dhe mendimit dhe të gjykojë për fenomenet politike.

Aftësitë e komunikimit

- Mund të përgatisë fjalime politike si dhe të përdorin terminologji politike.
- Mund të japë përfundime për hulumtimet shkencore dhe t'i prezantojë njohuritë e tij para një auditori më të gjerë, jashtë skenës tradicionale akademike.
- Mund të artikulojë informata dhe ide të partive politike dhe të qytetarëve.

Aftësitë e të mësuarit

- Mund ta vazhdojë mësimin individualisht, të vetarsimohet dhe të zhvillohet gjatë gjithë jetës, duke u kujdesur edhe për qasjen e resurseve në kuadër të kornizave të sistemit politik.
- Mund të ndërmarrë iniciativa për identifikimin e nevojave për mësim të grupeve, institucioneve dhe të çështjeve komplekse politike.
- Është në gjendje t'i trajnojë qytetarët për të drejtat politike në përputhje me rendin juridik në Maqedoni.
- Demonstron njohuri të avancuara për mënyrat e të mësuarit të sistemeve politike, qasje normative kundrejt asaj teorike dhe empirike, strategji cilësore kundrejt atyre sasimoreve për hulumtim të teorive bashkëkohore dhe klasike të sistemeve politike.

Lista e lëndëve

Semestri 1

- [MCDP1020] [6.0 SETK] **Institucionet ndërkombëtare**
- [MCPS1014] [6.0 SETK] **Zgjidhja e konflikteve**
- [MCPS1015] [6.0 SETK] **Politikat krahasimtare**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore e lirë**

Semestri 2

- [MCPA3040] [6.0 SETK] **Menaxhmenti politik**
- [MCPS3010] [6.0 SETK] **E drejta ndërkombëtare publike**
- [EMPS2040] [6.0 SETK] **Analiza e politikës së jashtme**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore e lirë**

Semestri 3

- [MCPA1010] [6.0 SETK] **Metodologjia e hulumtimi**
- [MCPS3011] [6.0 SETK] **Shoqëria dhe politika**
- [MCPS3012] [6.0 SETK] **Sistemi i së drejtës ndërkombëtare humanitare**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**

Semestri 4

Description of courses

Lëndë obligative

- **Institucionet ndërkombëtare**

Në kuadër të kësaj lënde përfshihen çështjet teorike në lidhje me institucionet ndërkombëtare të nivelit universal dhe rajonal, me zhvillimin e tyre historik, rolin, funksionet dhe përgjegjësitë. Vëmendje e veçantë i kushtohet rolit të tyre në zgjidhjen e problemeve kolektive dhe çështje në politikën globale. Fokusi është në rolin e tyre në sferën e paqes dhe sigurisë, zhvillimin ekonomik, të drejtat e njeriut, në demokracinë dhe sundimin e ligjit. Po ashtu fokusohet edhe në organet kryesore të përcaktuara në kuadër të institucioneve përgjegjëse për arritjen e qëllimeve të caktuara.

- **Zgjidhja e konflikteve**

Lënda trajton procedurat gjyqësore dhe jogjyqësore për zgjidhjen e konflikteve në mes shteteve. Në të flitet edhe për rolin e bisedimeve, ndërmjetësimin, vendosjen e paqes si dhe për rrolin e Kombeve të Bashkuara për zgjidhjen paqësore të konflikteve ndërkombëtare. Kjo lëndë po ashtu trajton edhe sistemin e arbitrazhit ndërkombëtar, atë ad hok dhe atë në suazat e tribunaleve ekzistuese siç janë Irani dhe SHBA-të, Tribunali Klejms dhe ICSID. Do të mësohen edhe procedurat dhe praktikatat e konflikteve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut në të drejtën tregtare dhe të drejtën e ujërave.

- **Politikat krahasimtare**

Lënda "Politikat krahasimtare" ka për qëllim furnizimin e studentëve me njohuri rreth politikave më të zhvilluara në periudhën e sotme, nënkuptohet duke mos i lënë mënjanë edhe vendet të cilat e rrethojnë RM-në si dhe sistemet politike të vendeve më pak të zhvilluara në të gjithë botën. Kjo lëndë është pjesë e studimeve deridiplomike dhe studimeve pasdiplomike në të shumtën e rasteve në fakultetet e administrimit publik, fakultetin juridik si dhe fakultetin e shkencave politike. Në përmbajtjen e të gjithë lëndës bëhen paralele dhe analiza krahasuese në mes funksionimit të institucioneve të sistemeve politike në vendet të cilat mësohet, si në mes vetes ashtu edhe në rastin e sistemit politik në Republikën e Maqedonisë, në drejtim të gjetjes së praktikave të mira me të cilat do të avancohej ky sistem në Republikën e Maqedonisë.

- **Menaxhmenti politik**

Qëllimet kryesore të lëndës janë: - Përfitimi i njohurive të termit politikë publike dhe menaxhment. - Të njihet me mjetet kryesore për aktivitetet në lidhje me dallimet e proceseve politike në krahasim me kriteret politike. - Përfitimi i njohurive adekuate për përgatitjen e anketave dhe punës në teren. - Zbatimi i njohurive të përfituara nga lëndët tjera dhe ndërtimi i një metodologjie të posaçmepër punimin e eseve dhe të punimeve seminarike. - Të analizohen proceset zgjedhore dhe mënyra e manifestimit të tyre. - Të përgatiten fjalime politik dhe të simulohet dukuria e ngjarjeve politike. - Gatishmëri për pjesëmarrje aktive në debate të organizuara të Bashkimeve studentore. - Aftësi për t'u përgatitur dhe për të marrë pjesë në projekte hulumtuese, si dhe prezantimin e rezultateve nga hulumtimet e realizuara. - Të determinojë metoda të ndryshme dhe të përdorë burime shkencore, të mësojë në mënyrë selektive dhe krahasimtare dhe të analizojë proceset politike.

- **E drejta ndërkombëtare publike**

Përmbajtja e lëndës është e përgatitur në atë mënyrë që cilën studentët të njihen me konceptet bazike të së drejtës ndërkombëtare publike, shpesh herë e identifikuar si e drejta ndërkombëtare, e cila bazat e veta i ka aty kah shek. XVII, si e drejtë e popujve, ku sot edhe dëshmon qartë ekzistimi i organizatës universale, Organizata e Kombeve të Bashkuara. Do të njihen gjithashtu edhe me të drejtën ndërkombëtare publike bashkëkohore e cila i rregullon marrëdhëniet midis shteteve, mes shteteve dhe organizatave ndërkombëtare, marrëdhëniet në mes vetë organizatave ndërkombëtare të shteteve, sjelljet e personave fizikë dhe juridikë për të cilat shtetet dhe organizatat ndërkombëtare konsiderojnë se janë të rëndësishme për to dhe për bashkësinë ndërkombëtare në përgjithësi.

- **Analiza e politikës së jashtme**

Në këtë lëndë, përmes analizës së punimeve në lidhje me politikën e jashtme, studentët do të aftësohen se si dhe çfarë mjeteve diplomatike mund të përdoren për situata konkrete. Pritet që studentët në mënyrë kritike të mendojnë në raport me metodat politike të cilat shtetet dhe organizatat ndërkombëtare i ndërmarrin si dhe për ndërlidhjen e tyre me metodat diplomatike.

- **Metodologjia e hulumtimi**

Kjo lëndë është e dizajnuar për studentët të cilët përgatiten për punimin e tezës së magjistraturës. Qëllimet kryesore janë që studentëve t'u ofrohen mjete për conceptualizimin e tezës së tyre me qëllim të gjetjes së çështjes së hulumtimit si dhe njohjen e metodave për mbledhjen e të dhënave përmes analizës sasiore dhe cilësore. Lënda është e fokusuar tek problemet e metodave dhe teknikave sasiore, siç është analiza statistikore, tekste që janë të lidhura me teorinë dhe testimin e hipotezave. Më pastaj të rëndësishme janë, po ashtu, edhe temat për interferencë deskriptive dhe kauzale, longitudinale, studimet krahasimtare dhe studimet e rasteve. Qëllimi është analiza e të dhënave cilësore, vënia finale e të gjitha praktikave teorike dhe veprave në funksion të dizajnit të shkrimit të temës.

- **Shoqëria dhe politika**

Lënda shoqëria dhe politika ka për qëllim që studentëve të studimeve pasuniversitare t'u të ofrojë njohuri të zgjeruar në fushën e lëvizjeve sociale dhe flukseve. Kursi mbulon analizën e të dy teorive të shoqërisë dhe politikës, si dhe zbatimin praktik dhe efektet e këtyre. Vëmendje e veçantë u është kushtuar ideve kryesore që qëndrojnë prapa teorive, si dhe ngjashmëritë dhe dallimet midis tyre. Bëhet fjalë për një lëndë që kryen, ndër të tjera, edhe përpunimin e disa ecurive themelore sociale, duke filluar nga ato me të cilat ne të gjithë përballemi si qytetarë dhe akademikë. Studentëve u lihet në dispozicion një spektër i gjerë i literaturës nga autorë vendas dhe të huaj, gjë që do t'u mundësojë atyre t'i zgjerojnë dhe t'i zhvillojnë njohuritë në fushën e temave që janë subjekt i analizave. Si qëllime të kësaj lënde mund të theksohen këto në vijim: -Studentët të pajisen me njohuri të duhura në fushën e shoqërisë dhe politikës; - Studentët t'i kuptojnë konceptet themelore dhe teoritë e shoqërisë dhe politikës; -Studentët të krijojnë mendim logjik dhe kritik rreth kornizës shkencore të shoqërisë dhe politikës; -Studentët të aftësohen t'i njohin paradigmat dhe drejtimet themelore në shoqëri dhe politikë;

- **Sistemi i së drejtës ndërkombëtare humanitare**

Qëllimi i lëndës është studimi i sistemit ndërkombëtar për të drejtat e njeriut, politika dhe praktika. Lënda do t'i shqyrtojë mekanizmat globalë dhe rajonalë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, të drejtën ndërkombëtare humanitare dhe të drejtën ndërkombëtare penale. Do të analizohen dhe do të debatohen çështjet aktuale dhe zhvillimet në fushën e të drejtave të njeriut. Qëllimi është të promovohet një kuptim kritik i rroleve, evolucionit dhe i të ardhmes së institucioneve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Pas përfundimit me sukses të këtij moduli, studentët do të jenë në gjendje t'i kuptojnë bazat institucionale të regjimit modern të të drejtave të njeriut dhe ta kuptojnë rolin e shumë aktorëve të përfshirë në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

- **Punimi i magjistraturës**

Pas dhënies së provimeve, studenti mund të fillojë me procedurën e paraqitjes, së punimit dhe mbrojtjes publike të temës së magjistraturës. Studenti zgjedh mentorin, me udhëzimin e të cilit e përgatit aplikimin e tezës së magjistraturës. Aplikimi patjetër duhet të lejohet nga Këshilli mësimor-shkencor i fakultetit. Pas punimit të versionit final të tezës së magjistraturës, Këshilli mësimor-shkencor formon komision tre anëtarësh, i cili përgatit raport, me çka pranohet ose refuzohet teza e magjistraturës. Raporti pozitiv miratohet nga Këshilli mësimor-shkencor dhe caktohet dita e mbrojtjes publike.

Lëndë zgjedhore

- **Analiza e politikës së jashtme**

Në këtë lëndë, përmes analizës së punimeve në lidhje me politikën e jashtme, studentët do të aftësohen se si dhe çfarë mjetesh diplomatike mund të përdoren për situata konkrete. Pritet që studentët në mënyrë kritike të mendojnë në raport me metodat politike të cilat shtetet dhe organizatat ndërkombëtare i ndërmarrin si dhe për ndërlidhjen e tyre me metodat diplomatike.

- **Diplomacia dhe metodat diplomatike**

Në kuadër të kësaj lënde të avancuar trajtohen: funksionet e diplomacisë, ndërtimi dhe parandalimi i marrëdhënieve diplomatike, relacionet në mes politikave të diplomacisë ndërkombëtare, shërbimet sekrete diplomatike, spiunimi, por edhe parimet, praktikat dhe problemet e imunitetit diplomatik. Po ashtu, lënda trajton organizimin e misioneve diplomatike jashtë, rolin e ambasadorëve dhe të shërbimeve të tjera diplomatike, përfshirë edhe përgjegjësinë që kanë ndaj qeverive të tyre si dhe raporti i tyre me qeveritë e vendeve në të cilat ato janë emëruar. Bëhet analizë se sa Qeveria është e lidhur me komunikimin, konfliktin, menaxhimin, bisedimet, si dhe diskutohet diplomacia e specializuar dhe ndikimi i teknologjisë në diplomaci. Gjithashtu, lënda ofron trajnim të specializuar për strukturat dhe mekanizmat e diplomacisë me shfrytëzimin e teknikave simulative. Zhvillon, aftësitë e përcaktuara për shkrimin dhe fjalimin, etikën profesionale, teknikat e bisedimeve, si dhe mëson organizimin burokratik. Studentët aftësohen edhe për raporte analitike dhe faktike, memorandume, propozime për korrespondencë formale diplomatike dhe për

aspekte të raporteve me publikun, raporte publike dhe konferenca për shtyp.

- **Lidershipi dhe zhvillimi organizativ**

Në lëndën liderishipi dhe zhvillimi organizativ, mësimi zbatohet si pjesë e programit studimor në administrimin publik. Lënda ka për qëllim që t'u mundësojë studentëve mënyrën si liderët dhe udhëheqësit e zhvillojnë dhe zbatojnë arritjen e misioneve dhe vizioneve të organizatave të caktuara në sektorin publik, zhvillimin e vlerave të cilat janë të domosdoshme për suksesin e mëtejshëm dhe zbatimin e tyre përmes aktiviteteve të ndryshme dhe shprehive, si liderët dhe organizata do t'i zbatojnë dhe do të zhvillohen. Gjithashtu, për mënyrën se si organizata e zbaton misionin dhe vizionin e saj përmes një strategjie të qartë të bazuar në mendimet e të gjitha palëve të interesuara dhe të përkrahur nga të gjitha politikat, planet, proceset dhe qëllimet relevante.

- **Politikat botërore**

Që të kuptohet politika botërore e shekullit të 21 nevojiten informacione të sakta dhe të përditësuara, analizë dhe interpretim intelektual. Bota është në proces të ndryshimeve të vazhdueshme dhe të shpejta, prandaj është e nevojshme të përshkruhet me saktësi, të shpjegohet dhe të parashikohet ngjarje dhe çështje madhore që zbulohen në marrëdhëniet ndërkombëtare. Ky detyrim intelektual duhet të qartësohet në mënyrë të tillë që qytetarët, studentët dhe politikëbërësit e botës të mund ta shfrytëzojnë këtë njohuri dhe t'i ndërtojnë vendimet e tyre për përballje me problemet globale që janë të pranishme.

- **Bashkimi Evropian: institucionet, politikat dhe e drejta**

Kjo lëndë ka për qëllim që të njohë studentët me kompleksitetin dhe zhvillimin e Bashkimit Evropian, dhe me këtë edhe me zhvillimin e institucioneve (politikat dhe të drejtën), natyrën e tyre dhe veçoritë, legjislacionin dhe politikat. Njëkohësisht, qëllimi kryesor është njohja e studentëve me konceptet kryesore teorike dhe zhvillimin e Bashkimit Evropian, si dhe të jep pëlqim të mundësive aktuale dhe sfidave të së ardhmes, me të cilat ballafaqohet Bashkimi Evropian, para së gjithash, në raport me institucionet e tij, me politikat dhe të drejtën.

- **Etika në politikë**

Qëllimet e lëndës: - Ka njohuri dhe e kupton semantikën dhe konceptet e moralit të etikës, standardet e sjelljes, përsiatjen morale dhe filozofinë morale. - Zhvillon qëndrim për pozitën e moralit në jetën profesionale. - Formon qëndrime të qarta për të drejtat dhe detyrimet e të punësuarve në administratën publike dhe ate shtetërore. - Aftësi për t'u ballafaquar me situata problematike etike. - Ka ndjenjë për karakterin e nevojshëm në profesionin e administratorit. - Është i njohur me literaturën për etikën në sferën e administrimit publik. - Është i gatshëm për të përdorur mjete të komunikimit dhe t'i respektojë standardet etike në punë me institucionet shtetërore dhe me aktorët publikë.

- **Terrorizmi ndërkombëtar**

Lënda terrorizmi ndërkombëtar është paraparë të analizojë terrorizmin në përgjithësi, duke i dhënë rëndësi të veçantë terrorizmit si një formë e veçantë e dhunës politike. Nga ky aspekt mund të përcaktohen qëllimet bazë të lëndës: - Studentët të furnizohen me njohuri specifike për natyrën e terrorizmit. - Studentët të pajisen me njohuri përkatëset për historinë e terrorizmit. - Studentët të njihen me njohuritë themelore teorike për grupet më të mëdha terroriste në botën bashkëkohore globale. - Studentët të njihen me qasjet themelore dhe me strategjitë për përballjen me terrorizmin bashkëkohor. - Studentët të krijojnë mendime kritike për efektet nga aktet e terrorizmit, duke i shqyrtuar edhe qëllimet themelore për nxënien e tyre. - Studentët të jenë në gjendje t'i analizojnë në mënyrë kritike reagimet dhe masat për luftimin e terrorizmit të ndërmarrë nga autoritetet kombëtare në pjesë të ndryshme të botës dhe në Republikën e Maqedonisë.

- **Zhvillimi i qëndrueshëm**

Në këtë lëndë studentët do të pajisen me njohuri të përgjithshme të cilat i referohen zhvillimit të qëndrueshëm si një koncept i ri i cili imponohet në skenën globale e cila mund të paraqesë një ndalesë në planetin Tokë. Studentët do të pajisen me dije rreth konceptit të zhvillimit të qëndrueshëm, kuptimin dhe konceptin superior për zhvillimin e qëndrueshëm, ndryshimet globale për mjedisin jetësor, të kuptuarit e parimeve dhe dimensionet e qëndrueshmërisë, do të jetë në gjendje të njihet me politikat e Bashkimit Evropian rreth zhvillimit të qëndrueshëm dhe do të kuptojë se si atë në rastin e praktikës së Maqedonisë krijohen si politika të kësaj kategorie. Njohuritë e marra në këtë lëndë do të ndihmojnë shumë për të përforcuar dijet dhe njohuritë e përgjithshme për zhvillimin e qëndrueshëm në nivel ndërkombëtar, në nivel të Bashkimit Evropian dhe vendeve anëtare të saj si dhe në Republikën e Maqedonisë.

- **Retorika**

Retorika, përgjatë historisë së vet prej mbi 2500 vjeçare, retorika shfrytëzohet për shënjimim e shumë gjërave, por sot me retorikë kuptojmë artin e bindjes nëpërmjet të gjuhës. Retorika shënon mënyrën në të cilën një individ

ndërlidhet me një ide apo një ide me qëllim ta bindë tjetrin. Retorika karakterizohet me disa tipare kryesore dalluese. E përkufizon qendrën nga e cila, kjo lëmi, zbulohet. Retorika më së pari l përkufizon situatat e caktuara tipike të të folurit.

- **Multilingualizmi dhe multikulturalizmi**

Qëllimi i kësaj lënde është shqyrtimi i shumëgjuhësisë në shoqëritë multikulturore, si fenomen social. Ky fenomen është masiv në mbarë botën. Gjatë ligjëratave në mënyrë më të thuktë do të shqyrtohen termat: monokulturalizëm, shumëkulturalizëm, multikulturalizëm. Do të sqarohet nocioni nacionalizmi lingvistik, ku do të theksohet se të paktën ka dy forma të këtij nacionalizmi, ku njëra formë përplasat me tjetrën: për udhëheqësit e vendeve më të fuqishme nacionalizmi ka domethënien e zgjerimit, kurse për pakicat ai merr formën e rezistencës dhe të luftës për afirmimin e identitetit, përballë një presionit të tillë. Vend të shquar në program do të ketë edhe multikulturalizmi në arsim. Në shkollë për multikulturalizmin angazhohen për programe mësimore që përfshijnë përmbajtje që u përkasin kulturave të ndryshme.

- **Kapituj të zgjedhur të avancuar nga aplikacionet e TI për përpilimin e një punimi shkencor**

Qëllimi i kësaj lënde është: T'u tregojë studentëve elementet teknike, struktura e tekstit dhe dizajni i një punimi shkencor. T'u mundësojë studentëve të fitojnë njohuri më të thelluara dhe shkathtësi nga kapitujt e zgjedhur të aplikacioneve TI që do t'u duhen për përpunimin e punimeve shkencore e profesionale. Zbatimi praktik i këtyre objektivave, gjatë përpunimit të punimit individual shkencor.

- **Kapituj të zgjedhur të avancuar nga aplikacionet për përpunimin statistikor të të dhënave**

Qëllimi i kësaj lënde është: T'u tregohen studentëve elementet teknike nga lëmi i statistikës: organizimi, përpunimi, krahasimi përmes analizave dhe publikimi i të dhënave. T'u mundësojë studentëve të përfitojnë njohuri dhe shkathtësi më të përparuara nga kapitujt e zgjedhur të avancuar të aplikacioneve për përpunimin statistikor të të dhënave. Zbatimi praktik i këtyre objektivave në përpunimin statistikor të të dhënave të marra nga pyetësorët, kontributet, studimet shkencore dhe dokumentet tjera.

- **Komunikimi profesional**

Lënda fokusohet në zhvillimin e atyre shkathtësive të komunikimit që janë thelbësore për funksionimin efektiv në botën profesionale. Studentët do ta mësojnë procesin e analizimit të një shumëllojshmërie situatash të komunikimit dhe t'u japin përgjigje adekuata po atyre. Ndër temat që do të përfshihen janë: komunikimi në organizata, komunikimi ndërpersonal dhe grupor, prezantimet gojore, intervistat për punësim, letrat profesionale të biznesit, si dhe shkathtësitë ndërpersonale, duke përfshirë dinamikën e grupit dhe punën ekipore.

- **Tregu i punës**

Qëllimi kryesor i lëndës "Tregu i punës" është t'i pajisë studentët e studimeve të ciklit të dytë me njohuritë bazë dhe njohuritë e thelluara në fushën e teorisë të tregut të punës, pastaj me mekanizmin e funksionimit të tij në ekonominë e tregut. Lënda "Tregu i punës" ka si mision t'u ofrojë dhe t'u mësojë studentëve kategoritë, ligjet dhe parimet kryesore me të cilat funksionon tregu i punës. Lënda u bën një analizë të hollësishme mënyrës së sjelljes dhe rolit që luajnë agjentët kryesorë të tregut të punës: individëve, firmave dhe qeverisë. Analiza mbështetet në dy kategoritë themelore: të kërkesës për punë dhe të ofertës së punës, të cilat gjejnë aplikim pothuajse në të gjitha temat që trajtohen në këtë lëndë. Njohuritë e përfituara nga studentët në këtë lëndë shërbejnë si bazë teorike themelore e domosdoshme për të kuptuar e përvetësuar teoritë dhe politikatat e ndryshme që aplikohen në tregun e punës. Lënda synon që studentët të kuptojnë se si tregjet e punës shpërndajnë dhe përdorin në mënyrë efikase faktorin e rrallë të prodhimit, punën. Leksionet përfshijnë njohuri të koncepteve të kërkesës për punë e të ofertës së punës dhe aplikimit të tyre praktik; sjelljen e individëve në tregun e punës për të maksimizuar dobishmërinë e tyre; sjelljen e firmave në tregun e punës që synojnë maksimizimin e fitimit; rolin e qeverisë në tregun e punës, strukturat e ndryshme të tregjeve të punës: tregu i punës në konkurrencë të plotë, monopoli në tregun e punës, monopsoni në tregun e punës, roli i sindikatave në tregun e punës, monopoli bilateral në tregun e punës. Leksionet dhe diskutimet në klasë mbulojnë materiale të cilat mund të mos jenë në libër dhe disa aspekte të materialeve që përfshihen në librin bazë nuk do të diskutohen në klasë, por i lihen studimit aktiv të studentit. Prandaj studenti, për të garantuar suksesin në përvetësimin sa më të mirë të lëndës, duhet të jetë i pranishëm në leksion dhe seminar duke marrë pjesë në mënyrë aktive në diskutimin e problemeve të ndryshme që lidhen me tregun e punës.

- **Metodologjia e mësimdhënies**

Qëllimi i lëndës është t'i njoftojë studentët me qasjet themelore dhe metodat e mësimdhënies. Pritet që studentët të fitojnë njohuri dhe shkathtësi për përdorim të mjeteve për mësimdhënie aktive. Gjithashtu, lënda ofron qasje ndaj zhvillimit, mësimdhënies dhe të nxëniet si koncepte, si dhe ndaj normave themelore të cilat mësimdhënësve do t'u mundësojnë të ligjërojnë mbi zhvillimin e mendimit. Përmes kësaj lënde, studentët do të përfitojnë bazë teorike dhe strategji, me çka do të mund ta zhvillojnë të menduarit e tyre kritik, si dhe të menduarit kritik të studentëve.

- **Filozofia e shkencave shoqërore**

Kjo lëndë përfshin pajisjen e studentëve me informata që do t'u mundësojnë atyre përfitimin e diturive, shkathtësive dhe kompetencave në shkencat shoqërore, përfshirë metodologjinë e punës (sqarim, teoretizim, testim), aplikim të filozofisë (në veçanti individualizmi kundrejt kolektivizmit), natyra e racionalitetit, si dhe historia e teorive dhe koncepteve. Ky modul ofron studim të avancuar të debateve aktuale lidhur me ontologjinë, metodologjinë dhe synimet e shkencave shoqërore. Lënda do të përqendrohet në çështjet qendrore të shkencave shoqërore: etno-metodologjia, evolucioni, fenomenologjia, racionaliteti, relativizmi, metodat shkencore, interpretime tekstuale. Rezultat e të mësuarit: Pas përfundimit të suksesshëm të lëndës, studentët do të jenë në gjendje: Ta kuptojnë qëllimin e shkencave shoqërore si dhe dallimin në mes të të sqaruarit dhe të kuptuarit të sjelljes njerëzore. T'i sqarojnë qasjet e ndryshme në shpjegimin e shkencave shoqërore në krahasim me shkencat shoqërore, specifikat e të qenit qenie njerëzore dhe fenomenet sociale. T'i kuptojnë strukturat sociale, praktikat, normat institucionet etj. si dhe relacionet në mes individëve dhe strukturave më të gjera shoqërore. Ta sqarojnë mbështetjen jo vetëm në fakte për individët dhe gjendjet e tyre mentale, por gjithashtu edhe rastet në të cilat fenomenet shoqërore nuk mundet të sqarohen përmes sjelljeve individuale.

- **Menaxhimi i projekteve**

Me përfundimin e suksesshëm të lëndës, studentët do të jenë në gjendje: Të planifikojnë aktivitetet e nevojshme për zbatimin e projektit, të identifikojnë ndërvarësitë e tyre, kohëzgjatjen si dhe kostot e tyre; Të përgatisin raportet e nevojshme dhe të kryejnë të gjitha komunikimet e nevojshme ndërmjet projektit dhe klientit, si dhe në mes të anëtarëve të ekipit dhe të aktorëve të tjerë; Të strukturojnë projektin dhe aktivitetet e tij përbërëse; Të përgatisin një Gantt-tabelë dhe një plan të rrjetit për projektin dhe të identifikojnë kohën më të shkurtër të nevojshme për të përfunduar projektin; Të përdorin MS Project si një mjet në procesin e planifikimit, zbatimit dhe rishikimit të projektit; Të përcaktojnë projektin, të identifikojnë lëminë dhe objektivat e tij, si dhe të zhvillojnë specifikat e projektit;

- **Metodat e optimizimit**

Qëllimi i kësaj lënde është që t'i prezantojë teknikat e modelimit dhe të optimizimit me qëllim të aftësisë të studentëve në zhvillimin e modeleve të cilat shfrytëzohen për zgjidhjen e problemeve reale në lëmin e shkencave kompjuterike. Në mes tjerash kjo lëndë ka për qëllim ta analizojë rëndësinë e faktorizimit matricor si një mjet shumë i rëndësishëm që ofron modalitete për optimizimin e zgjidhjes së algoritmeve të ndryshme numerike me interes bazik për zgjidhjen e problemeve të ndryshme nga sfera e shkencave kompjuterike. Nëpërmjet kësaj lënde studentët do të kenë mundësi t'i mësojnë teorinë bazike të optimizimit edhe metodat për caktimin e optimumit. Do të analizohen metodat e ndryshme të optimizimit sikurse që është simpleks metoda, problemi i dualitetit si dhe sensitiviteti i problemeve të programimit linear. Qëllimi, po ashtu, është analiza e zbatimit kompjuterik të secilit problem të analizuar duke ofruar edhe modelin përkatës për optimizim.

- **Çështjet etike dhe e drejta në teknologjitë e informacionit (TI)**

Qëllimet e lëndës: Të zhvillon kuptueshmërinë për gjendjen reale në relacionet mes kompjuterëve, ndryshimeve të teknologjisë, shoqërisë dhe ligjit; Të vejë në pah rolin e fuqishëm që kompjuterët dhe profesionistët e kompjuterëve kanë në shoqërinë e teknologjisë; Të ofron të kuptuarit e çështjeve legale që janë relevante për lëminë e kompjuterizimit; Të ofron të kuptuarit e koncepteve etike që janë me rëndësi për shfrytëzuesit e kompjuterëve dhe profesionistët; Të kontribuon në arritjen e eksperiencës së nevojshme në shqyrtimin e çështjeve etike dhe zgjidhjen e dilemave etike.

- **Mbrojta e të drejtave të njeriut**

Qëllimi i kësaj lënde është: të njoftohen studentët me konceptin e të drejtës ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, zbatimin e këtyre të drejtave në praktikë, ndikimin e tyre në krijimin e politikave nacionale, të nxiten studentët të mendojnë në mënyrë kritike për raportin mes të drejtës ndërkombëtare dhe asaj nacionale, të vetëdijësohen për ngjarjet aktuale ndërkombëtare, si ndikojnë ato në jetën e përditshme të njerëzve në botë, ti nxisë studentët ta japin kontributin e tyre në sferën e përgatitjes së ligjeve për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, me shpresë se ata që sjellin vendime do i marrin parasyshtë në procesin e krijimit dhe zbatimit të politikave shtetërore.